URDHËR
Nr. 490, datë 25.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, si vijon:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, në emër të nëpunësit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha gjykatat dhe shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si edhe t'i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Arsimit;

c) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Arsimit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

d) vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe rishikimin e tij sipas së njëjtës procedurë që është miratuar, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit;

e) të nënshkruajë marrëveshje për Ministrinë e Arsimit, me palë të treta sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;

f) të nënshkruajë urdhrat për ngritjen e grupeve të punës me nëpunës të Ministrisë së Arsimit apo strukturave vartëse për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore që mbulon fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit;

g) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Arsimit;

h) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Arsimit me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

i) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër apo autorizim nga ministri.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

3. Urdhri nr. 523, datë 15.9.2023, "Për delegimin e kompetencave", shfuqizohet.

4. Ngarkohet z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit në Ministrinë e Arsimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi